



AAB-MASTER
RESEARCH METHODS
METODAT E HULUMTIMIT SHKENCOR

Teknologjia e punës shkencore kërkimore

Teknologjia e punës përfshin këto faza:

2

1. Identifikimi i problemit kërkimor,
2. Shtruarja e hipotezës,
3. Zgjedhja dhe analiza e temës (titulli),
4. Përpunimi i planit orientues të punës shkencore kërkimore,
5. Përcaktimi i bibliografisë që do të shfrytëzohet për punën konkrete,
6. Grumbullimi, përpunimi dhe sistemimi i literaturës,
7. Struktura komponuese e veprës shkencore ose profesionale,
8. Zgjidhja e problemit të shtruar shkencor,
9. Formësimi me shkrim i rezultateve kërkimore,
10. Implementimi i rezultateve kërkimore,
11. Kontrolli i zbatimit (implementimit) të rezultateve kërkimore.

Identifikimi i problemit kërkimor

3

- Problemi në përgjithësi, në aspektin etimologjik dhe semantik është çështje teorike ose praktike, që duhet të zgjidhet.
 - ▣ Në mes problemit dhe objektit për kërkim ekziston interaksion i fortë, porse nuk janë sinonime.
 - ▣ **Problemi** është element themelor i kërkimeve, me fjalë tjera mund të konsiderohet se është motiv për kërkime shkencore e profesionale.
- Nga problemi rrjedh definimi i objektit për kërkim.

- Ndërkaq, nga problemi dhe lënda për kërkim shtrohet hipoteza, e cila ose duhet të vërtetësohet ose të hedhet.
- Pas identifikimit dhe definimit të problemit shkencor duhet të caktohet:
 1. përfshirja hapësinore e problemit kërkimor,
 2. përfshirja kohore dhe,
 3. përfshirja populative.

Shtruarja e hipotezës

5

- Hipoteza është supozim shkencor, e shtruar për shpjegimin e ndonjë dukurie, për ta konfirmuar ose për ta hedhur.
- Shtruarja e hipotezës mbështjen e ka në këto burime themelore:
 - ▣ nevoja për zgjerimin e njohurive,
 - ▣ nevoja për mbizotërimin e mangësive në njohuritë e arritura,
 - ▣ nevoja për kontrollin e pandërprerë të dozës së aktualitetit të njohurive të përvetësuar.

Zgjedhja dhe analiza e temës (titullit)

6

- Titulli i veprës shkencore ose profesionale duhet:
 - të shpreh përmbajtjen bazë të saj,
 - të jetë i shkurtër,
 - të jetë i qartë,
 - të jetë tërheqës dhe,
 - të jetë informativ.

- Të formulimi i titullit, është e domosdoshme t'i iket:
 - gjatësisë,
 - pretenciozitetit,
 - disproporcioneve kundrejt përmbajtjes.

Përpunimi i planit orientues të punës shkencore kërkimore

7

- Planet e tilla janë të karakterit të planit kornizë, që përfshinë grumbullimin e materialit, të të dhënave, të informacioneve dhe të burimeve përkatëse e të rëndësishme.
 - Plani duhet të jetë rezultat i të menduarit paraprak, i një lloj përvoje dhe i motiveve për t'i hyrë hulumtimeve që mund të konsiderohen relevante dhe me vlerë.
- Për të bërë plan të mirë dhe të qëndrueshëm, studiohet literatura, shfrytëzohen përvojat e tjerë, për të përkufizuar atë që do të jetë dobiprurëse me rastin e hulumtimit dhe të mbarështrimit të rezultateve përfundimtare.
 - Plani orientues për punë shkencore kërkimore, është bazë e mbarështrimit të Projektit kërkimor, por meqë plani gjendet në fazën nismëtare, mund të quhet Plani ideor. Ndërkaq, nëse është i detajizuar, mund të jetë i karakterit të Planit implementues.

- Plani i punës shkencore kërkimore duhet t'i përfshijë këto çështje:
 - problemin dhe lëndën e kërkimit,
 - synimet dhe objektivat e kërkimeve,
 - strukturën ose kompozicionin e projektit,
 - metodat e hulumtimeve,
 - afatet e kërkimeve,
 - bartësit e detyrave të caktuara të kërkimeve.
 - mjetet financiare dhe mjetet tjera të nevojshme për realizimin e kërkimeve,
 - objektivat për kontributet nga rezultatet kërkimore që do të shfrytëzohen në praktikë.

Përcaktimi i bibliografisë së punës

9

- Për kryerjen e punës shkencore kërkimore, rëndom shfrytëzohet bibliografia përkatëse.
 - Ekzistojnë dallime në mes bibliografisë së punës dhe bibliografisë përfundimtare.
- **Bibliografia e punës** është e karakterit nismëtar dhe orientues, me të cilën mundësohet shqyrtimi dhe realizimi i punës shkencore kërkimore. Prej saj fitohen informacione, modele dhe përvoja se si janë hartuar temat, si janë përdorur teknikat, përvojat e tjerë.
- **Bibliografia përfundimtare**, që shënohet në fund të veprës shkencore ose profesionale, shkencore-profesionale, është më e gjerë, d.m.th. përfshihet tërë opusi bibliografik, i shfrytëzuar për mbarë shtrimin e veprës përkatëse.

- Në spektrin e njësive bibliografike radhitën:
 - librat,
 - revistat shkencore,
 - artikujt,
 - referatet,
 - studimet, burimet nga interneti,
 - shkrimet e panënshkruara (anonime)
 - e tjerë.

Grumbullimi, studimi dhe rregullimi (sistemimi) i literaturës dhe i materialit tjetër

11

- Kjo është faza më e vështirë, më e ndërlikuar, më me përgjegjësi në teknologjinë e punës shkencore kërkimore.
- Përfshinë katër nënfaza:
 - ▣ Identifikimi dhe grumbullimi i literaturës, i materialeve dhe informacioneve shkencore relevante (burimet parësore, dytësore dhe tretësore),
 - ▣ Studimi i materialeve të grumbulluara,
 - ▣ Seleksionimi, analiza dhe sinteza e fakteve relevante,
 - ▣ Krijimi i konkluzionit të përgjithshëm (gjeneral).

Struktura ose komponimi i veprës shkencore/profesionale

12

- Sipas variantit të përgjithësuar ose përmbledhës:
 1. Hyrja.
 2. Përpunimi,
 3. Përmbyllja.

Zgjidhja e problemit të shtruar shkencor

13

- Problemi shkencor i shtruar e merr formën e zgjidhur, nëse hipoteza e përcaktuar është e vërtetuar, ose eventualisht hipoteza është hedhur si e pa bazë.
- Si në rastin pozitiv, po ashtu, edhe në atë negativ, përmbillet procesi i zgjidhjes së problemit, me çka nënkuptohet se punët dhe aktivitetet tjera janë të ndërlidhura me ndonjë problem tjetër.

Përpilimi me shkrim i rezultateve kërkimore

14

- Disenjimi me shkrim i rezultateve kërkimore paraqet fazën e kurorëzimit të kontributit të shënuar nga puna shkencore kërkimore.
- Shkruarja e tekstit përfundimtar duhet të ketë mbështetje:
 - në rregullat relevante të të shkruarit,
 - në stil të zgjedhur,
 - në ilustrimet tabelare dhe grafike,
 - në strukturimin teknik siç rezultohet për zhanre të caktuara të veprave shkencore ose profesionale.

Teknikat dhe teknologjitë e punëve shkencore kërkimore

15

- Shfrytëzimi i të dhënave parësore
- Puna shkencore kërkimore është aktivitet i organizuar, prej së cilës rezultojnë veprat shkencore, profesionale dhe shkencore-profesionale.
- Puna shkencore kërkimore është e suksesshme dhe efektive, nëse shfrytëzon të dhëna relevante, pa marrë parasysh, cilit zhanër i përkasin.

- Plani i punës hartohet gati në mënyrë të njëjtë për:
 1. punimet e magjistraturës,
 2. disertacionin e doktoratës,
 3. studime shkencore ose profesionale,
 4. veprat e zhanreve të ndryshme të tipeve shkencore dhe të tipeve profesionale.

Plani i punës

17

- **Plani i punës** është udhërrëfyes i rëndësishëm, i cili:
 - trason rrugën e të vepruarit,
 - i operacionalizon fazat e punës dhe të veprimit,
 - i përcakton bartësit e përgjegjësisë,
 - të shpenzimeve,
 - i përcakton afatet kohore dhe të gjitha këto veprime kanë kahe drejtn sublimitit të rezultateve shkencore e profesionale,
 - të disenjuara në vepra përkatëse,
 - që do të jenë në funksion përdorues të shfrytëzuesve, të të interesuarve, për përçim dhenzgjerim të diturive të mëtejme, si dhe për lindje të motiveve dhe të kureshtjeve që të arriturave të shënuara, t'iu shtohen kërkime të reja.

Shfrytëzimi i bibliotekave